



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/142 Nr. i faq./Br. str./No. pg 08

Data/Datum/Date 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.05.2026, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Punës për Komitetin për Komunitete për vitin 2026

1. Me këtë vendim, **miratohet** Plani i Punës për Komitetin për Komunitete për vitin 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës për Komitetin për Komunitete për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Komiteti për Komunitete.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Zyra e Kuvendit,
- Anëtarëve të Komitetit për Komunitete,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.142/26

Datë:29.05.2026



Fatmir Iska

Kryesuesi i Kuvendit